



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



DATË/A	23.12.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefit Ekzekutiv te KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kompensimi ndaj konsumatorëve për investimet e planifikuara dhe të pa-realizara

Te nderuar,

Kërkesa vjetore për të ardhura që shfrytëzohet për përcaktimin e tarifave në ciklet tre-vjetore të shqyrtimit tarifor përfshihen kostot që lidhen me investimin e planifikuara në disa mënyra:

- Investimi i planifikuar në përtëritjen e infrastrukturës përfshihet drejtpërdrejt në kërkesën e të ardhurave në tërësi.
- Investimi i planifikuar në rritjen e infrastrukturës që i shtohet bazës rregulatore të aseteve (BRR) mbi të cilën kalon një kthim i kapitalit në kërkesën për të ardhura.
- Investimi i planifikuar në mirëmbajtjen dhe rritjen kapitale jo-infrastrukturore, që i shtohet BRR-së, përmes të cilit aplikohet zhvlerësimi sipas kostos aktuale dhe kthimi në BRR përfshihet në kërkesën e të ardhurave.

Konsultimi publik i *janarit 2024* ka potencuar çështjen e investimeve kapitale të pa realizuara. KRU-të përfshijnë shuma të konsiderueshme për investime kapitale në planet e tyre të biznesit, megjithatë pjesa më e madhe e këtij investimi të planifikuar nuk është realizuar. Duke qenë se investimet e financuara nga grantet nuk kanë ndikim në tarifa, ARRU është shumë e brengosur me nivelin e investimeve që pritej të financoheshin nga KRU-të, përfshirë edhe kreditë. Ky investim në përgjithësi lidhet me mirëmbajtjen kapitale të infrastrukturës së rrjetit shpërndarës dhe të objekteve të tjera. Gjatë periudhës 2021 – 2023 KRU-të planifikuan 16.9 milionë EUR në planet e tyre të biznesit për investime kapitale të financuara, pa përfshirë grantet, nga të cilat vetëm 6.9 milionë EUR u realizuan. Pjesa më e madhe e këtij investimi të pa realizuar ishte planifikuar në përtëritjen e infrastrukturës, që përfshihet e tëra në tarifë.

Në të kaluarën reagimi ynë ka qenë t'u mohojmë KRU-ve të drejtën e tyre për rregullimin vjetor të inflacionit në tarifa, siç lejohet sipas Rregulloreve të ARRU-së¹. Edhe pse kjo ka pasur efektin e kompensimit të

¹ Rregullore Nr. 12/2020 Për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet Ujore në Kosovë, Kapitulli III - Investimet kapitale dhe raportimi, Neni 10 - Stimulimi i ofruesve të shërbimeve përmes investimeve kapitale

konsumatorëve, ARRU konsideron këtë qasje si më pak të saktë dhe imponon të njëjtën masë për të gjithë KRU-të, pavarësisht se sa nga programet e tyre të investimeve janë realizuar.

Analiza e ARRU-së për investimet e planifikuara dhe faktike sugjeron se kërkesa e planifikuar për të ardhura gjatë periudhës 2021 – 2023, do të duhej të zvogëlohej për 9.1 milionë EUR nëse propozimet për investime në planin e biznesit do të krahasoheshin me programin aktual të investimeve. Këto janë para që janë paguar nga konsumatorët dhe do të justifikohet kërkesa për kthimin e parave të tyre. Ajo barazohet me një reduktim tarifor prej rreth 0,05 EUR për m³ ujë të shitur ose pak më pak se 8,00 EUR në vit për konsumatorë.

ARRU ka vendosur që për shqyrtimet e ardhshme tre-vjetore do të përfshijnë një modul të “tërheqjes/ kthimit të parave për investimet e pa realizuara” që do të harmonizojë investimin e realizuar kundrejt investimit të planifikuar për tre vitet para shqyrtimit. Procesi i përcaktimit të tarifave do të zbresë nga kërkesa për të ardhura shumat për të cilat konsumatorët kanë paguar për investimet e përfshira në përcaktimet tarifore në ciklin paraprak tre-vjetor të shqyrtimit tarifor, dhe që nuk janë realizuar ose janë realizuar me vonesë. Në rastet kur KRU-të kanë realizuar investime të nevojshme, e që nuk ka qenë planifikuar në shqyrtimin tarifor, kompensimi mund të rezultojë me një shtesë në kërkesën e ardhshme për të ardhura. Procesi i tërheqjes / kthimit të parave për investimet e pa realizuara përfshin koston e kapitalit të të ardhurave të pajtuara, d.m.th. konsumatorët do të kompensohen me interes për çdo mbipagim që kanë bërë.

Me futjen e këtij mekanizmi të tërheqjes së parave për investimet e pa realizuara, dispozitat aktuale që lejojnë ARRU-në të mos aplikojë rregullimet e inflacionit, siç është vepruar në të kaluarën, nuk janë më të nevojshme. Kjo dispozitë do të hiqet nga rregullorja përkatëse.

ARRU nuk do ta zbatojë këtë proces në mënyrë retrospektive, d.m.th. nuk do të ndërmarrë një kthim të investimeve të kaluara (nga shqyrtimi tarifor 2022-2024) për shqyrtimin e ardhshëm tarifor (2026-2028). Megjithatë, ARRU do të ndërmarrë një kthim të hollësishëm të shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara për periudhën 2026-2028 dhe të përfshijë në rregullimin e kërkesës për të ardhura për shqyrtimin tarifor 2029-2031.

ARRU tërheq vëmendjen tuaj në letrën tonë të mëparshme ku njoftuam vendimin tonë që kërkonte prova të forta mbështetëse për dorëzimin e ardhshëm të planit të biznesit. Kjo përfshin kërkesën për prova të forta për të mbështetur planet e investimeve dhe se ARRU nuk do ti marrte parasysh propozimet për investime që nuk janë të arsyetuara mirë, me përjashtim të shumave rezervë për investime të paplanifikuara emergjente. Çfarëdo shume e paraparë si rezervë dhe që ka mbetur e papërdorur do të përfshihet në procesin e tërheqjes së parave për investimet e pa realizuara. Prandaj presim që dallimi midis investimit të planifikuar dhe atij të realizuar në të ardhmen të jetë minimal.